# FLETORJA ZYRTARE
# E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**
**www.legjislacionishqiptar.gov.al**
**www.qpz.gov.al**

**Nr.115 23 korrik 2008**


## P Ë R M B A J T J A


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr.823, datë 11.6.2008 | Për kthimin e spitalit universitar të mushkërive “Shefqet Ndroqi” në spital universitar “Shefqet Ndroqi”……………………………… | 5043 |
| Vendim i KM nr.910, datë 18.6.2008 | Për miratimin e veprimtarisë private në fushën e shëndetësisë……. | 5043 |
| Vendim i KM nr.916, datë 2.7.2008 | Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Rrogozhinë të qarkut të Tiranës ……………………… | 5043 |
| Vendim i KM nr.917, datë 2.7.2008 | Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Thumanë të qarkut të Durrësit …………..……………… | 5044 |
| Vendim i KM nr.918, datë 2.7.2008 | Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Laç të qarkut të Lezhës …………………………………… | 5046 |
| Vendim i KM nr.919, datë 2.7.2008 | Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Fierzë të qarkut të Kukësit …………………………… | 5047 |
| Vendim i KM nr.920, datë 2.7.2008 | Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Sinjë të qarkut të Beratit ………………………………… | 5049 |
| Vendim i KM nr.921, datë 2.7.2008 | Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Topojë të qarkut të Fierit ……………….……………… | 5050 |
| Vendim i KM nr.922, datë 2.7.2008 | Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Fier të qarkut të Fierit……………………………………. | 5051 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr.923, datë 2.7.2008 | Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Çërravë të qarkut të Korçës ……………………………… | 5052 |
| Vendim i KM nr.930, datë 2.7.2008 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga zgjerimi i varrezave të qytetit, në bashkinë e Shkodrës ……………………………………………… | 5054 |
| Vendim i KM nr.931, datë 2.7.2008 | Për një shtesë në vendimin nr.335, datë 2.9.1997 të Këshillit të Ministrave "Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit", të ndryshuar …………………………………………… | 5055 |
| Vendim i KM nr.932, datë 2.7.2008 | Për përcaktimin e pagave dhe të shtesave mbi pagë të punonjësve shqiptarë, për kohën, që shërbejnë si oficerë kontakti, pranë ministrive të brendshme homologe të shteteve të ndryshme, të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë … | 5056 |
| Vendim i KM nr.933, datë 2.7.2008 | Për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Itali, Greqi, Turqi, Kosovë dhe EUROPOL ………………………………………………………… | 5058 |
| Vendim i KM nr.934, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Kiribatit ………………………………………………………… | 5059 |
| Vendim i KM nr.935, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën Palau | 5059 |
| Vendim i KM nr.936, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Grenadan ……..… | 5059 |
| Vendim i KM nr.937, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën Trinidad dhe Tobago ……………………………………………… | 5060 |
| Vendim i KM nr.938, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Belize-së …………………………………………………………… | 5060 |
| Vendim i KM nr.939, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Gambias …………………………………………………………… | 5060 |
| Vendim i KM nr.940, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Swazilendit ………………………………………………………… | 5061 |
| Vendim i KM nr.941, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Liberisë …………………………………………………………… | 5061 |
| Vendim i KM nr.942, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën demokratike të Timorit Lindor ……………………………………. | 5061 |
| Vendim i KM nr.943, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Çadit ………………………………………………………………………. | 5062 |
| Vendim i KM nr.944, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Ugandës …………………………………………………………… | 5062 |
| Vendim i KM nr.945, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën Vanuatu ………………………………………………………… | 5062 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr.946, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Bashkimit të Komorros ………………………………………… | 5063 |
| Vendim i KM nr.947, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me ishujt Solomon … | 5063 |
| Vendim i KM nr.948, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Bahamas ………………………………………………………… | 5063 |
| Vendim i KM nr.949, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Saint Kitts dhe Nevis …………………………………………………………… | 5064 |
| Vendim i KM nr.950, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Mbretërinë e Tongës ……………………………………………………………… | 5064 |
| Vendim i KM nr.951, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Saint Vincent dhe Grenadinë ………………………………………………………..… | 5064 |
| Vendim i KM nr.952, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Naurusë …………………………………………………………… | 5065 |
| Vendim i KM nr.953, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me ishujt Tuvalu …… | 5065 |
| Vendim i KM nr.954, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me shtetin e pavarur të Samoas …………………………………………………………… | 5065 |
| Vendim i KM nr.955, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Surinamit …………………………………………………………… | 5066 |
| Vendim i KM nr.956, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Ishujve Marshall ………………………………………………… | 5066 |
| Vendim i KM nr.957, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Ishujve të Fixhit ………………………………………………… | 5066 |
| Vendim i KM nr.958, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Saint Lucia ……… | 5067 |
| Vendim i KM nr.959, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Antigua dhe Barbuda …………………………………………………………… | 5067 |
| Vendim i KM nr.960, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Kongos …………………………………………………………… | 5067 |
| Vendim i KM nr.961, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me shtetin e pavarur Papua Guinea e Re ……………………………………………… | 5068 |
| Vendim i KM nr.962, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Ruandës …………………………………………………………… | 5068 |
| Vendim i KM nr.963, datë 2.7.2008 | Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me shtetet e federuara të Mikronezisë ……………………………………………………… | 5068 |
| Vendim i KM nr.964, datë 2.7.2008 | Për disa ndryshime në vendimin nr.160, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e numrit të punonjësve, për vitin 2008, në ministritë dhe institucionet qendrore", të ndryshuar …… | 5069 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr.965, datë 2.7.2008 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash ……………………………….………… | 5070 |
| Vendim i KM nr.966, datë 2.7.2008 | Për kriteret, që duhet të plotësojnë personat, fizikë dhe juridikë, për t'u pajisur me leje profesionale, për projektimin, konsulencën, vlerësimin, monitorimin dhe drejtimin teknik të veprimtarisë së shfrytëzimit të burimeve minerare ……………………………… | 5073 |
| Vendim i KM nr.967, datë 2.7.2008 | Për miratimin e kuotave kryesore të pranimit të studentëve në universitetin ushtarak "Skënderbej", për vitin akademik 2008-2009 …………………………………………………………….… | 5073 |
| Vendim i KM nr.968, datë 2.7.2008 | Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ……………………………………………………………… | 5074 |
| Vendim i KM nr.969, datë 2.7.2008 | Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në administrim Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), sh.a………………………………………. | 5077 |
| Vendim i KM nr.970, datë 2.7.2008 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i 6 puseve të shpimit, në Konjat, Lushnjë ……………………………..………… | 5081 |
| Vendim i KM nr.974, datë 2.7.2008 | Për dhënie fondi komunës Tërthorë, për realizimin e procedurave për zhvendosjen e varrezave të fshatit Morinë …..………………… | 5082 |
| Vendim i KM nr.976, datë 2.7.2008 | Për përballimin e shpenzimeve të palës shqiptare, pjesëmarrëse në operacionin ushtarak "EUFOR TCHAD/RCA", të Bashkimit Europian ……………………………………………….……… | 5083 |
| Vendim i KM nr.977, datë 2.7.2008 | Për rishpërndarje fondi në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes …………………………………………… | 5083 |
| Vendim i KM nr.978, datë 2.7.2008 | Për kalimin në pronësi nga ARMO, sha-ja, Tiranë, bashkisë Ura Vajgurore të një sipërfaqeje, truall, të degës së shpërndarjes së karburanteve, Ura Vajgurore, dhe për një ndryshim në vendimin nr.208, datë 16.4.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ARMO, sh.a.-së" …………… | 5084 |
| Vendim i KM nr.979, datë 2.7.2008 | Për dhënien në përdorim, pa shpërblim, të një sipërfaqeje, truall, komunitetit të Sant'Egidio-s (shoqatë jofitimprurëse)…..………….. | 5086 |
| Vendim i KM nr.980, datë 2.7.2008 | Për dhënien në përdorim, pa shpërblim, Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve "Vojo Kushi", të mjediseve të ish-mensës së studentëve ……………………………………………..…………… | 5086 |
| Urdhër i MF nr.82, datë 19.6.2008 | Për miratimin e primit të pastër të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta …………………………………………………………… | 5087 |

**VENDIM**
**Nr.823, datë 11.6.2008**

**PËR KTHIMIN E SPITALIT UNIVERSITAR TË MUSHKËRIVE "SHEFQET NDROQI" NË SPITAL UNIVERSITAR "SHEFQET NDROQI"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9106, datë 17.7.2003 "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Spitali universitar i sëmundjeve të mushkërive "Shefqet Ndroqi" të kthehet në spital universitar "Shefqet Ndroqi", si person juridik, publik, buxhetor, me kapacitet 300 shtretër, i nivelit terciar, që do të shërbejë si qendër e mjekimit, mësimit dhe kërkimit shkencor, për rajonin e Tiranës.

2. Drejtimi administrativ i spitalit të jetë në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa drejtimi institucional në varësi të dyfishtë, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si organe, që bashkërendojnë veprimtarinë e spitaleve universitare.

3. Funksionet mjekësore, mësimore dhe kërkimore-shkencore të spitalit të realizohen nga strukturat përkatëse, në nivel departamenti dhe shërbimi, në bashkëpunim me drejtorinë e spitalit.

4. Mënyra e organizimit, struktura dhe rregulloret e funksionimit përcaktohen nga Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

5. Drejtori i spitalit emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra nga Ministri i Shëndetësisë.

6. Ministria e Shëndetësisë kryen kompensimin financiar për shërbimin, që kryen stafi akademik i Fakultetit të Mjekësisë në spital, bazuar në kontratat përkatëse.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, dhe organika e spitalit të përballohen, përkatësisht, nga buxheti dhe numri i përgjithshëm i punonjësve, miratuar për vitin 2008, për Ministrinë e Shëndetësisë.

8. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

9. Në vendimin nr.70, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave "Për statusin e spitaleve universitare", të ndryshuar, të gjithë paragrafët, që i referohen spitalit universitar të sëmundjeve të mushkërive "Shefqet Ndroqi", shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.910, datë 18.6.2008**

**PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË PRIVATE NË FUSHËN E SHËNDETËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.3766, datë 17.12.1963 "Për kujdesin shëndetësor", të ndryshuar, të ligjit nr.8167, datë 21.11.1996 "Për shërbimin shëndetësor stomatologjik", të ndryshuar, të ligjit nr.7975, datë 26.7.1995 "Për barnat narkotike dhe substancat psikotrope", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9323, datë 25.11.2004 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, që duan të ushtrojnë veprimtarinë private

në fushën e shëndetësisë, i nënshtrohen procesit të licencimit.

2. Ministria e Shëndetësisë licencon veprimtaritë e mëposhtme:

a) Spitalet;

b) Fabrikimin e medikamenteve, të materialeve të mjekimit dhe pajisjeve mjekësore;

c) Import-eksportin dhe tregtimin, me shumicë e pakicë, të barnave narkotike dhe të substancave psikotrope.

3. Drejtoritë e shëndetit publik në rrethe licencojnë veprimtaritë e mëposhtme:

a) Import-eksport dhe tregtimin me shumicë të barnave dhe materialeve të mjekimit.

b) Hapjen e kabineteve mjekësore dhe të qendrave të diagnostikimit (vizita, konsulta);

c) Ngritjen e laboratorëve mjekësorë (klinikë-biokimikë, mikrobiologjikë, genetikë);

ç) Hapjen e kabineteve dentare (stomatolog, ndihmësstomatolog, laborant dentar);

d) Hapjen e farmacive dhe të agjencive farmaceutike;

dh) Shërbimet e dezinfektimit, të dezinsektimit e të deratizimit (DDT);

e) Veprimtari në fushën e optikës (Laborator optikë dhe optometrikë).

4. Për licencimin e veprimtarisë private në fushën e shëndetësisë zbatohet procedura e autodeklarimit, duke dorëzuar formularin e autodeklarimit.

5. Ministri i Shëndetësisë miraton formularin e autodeklarimit për secilën veprimtari në fushën e shëndetësisë.

6. Formulari i autodeklarimit dorëzohet nga subjekti pranë institucioneve shëndetësore, sipas përcaktimeve të bëra në pikat 2 e 3 të këtij vendimi.

7. Institucioni shëndetësor, i përcaktuar në pikat 2 e 3 të këtij vendimi, brenda 20 ditëve nga data e dorëzimit të formularit të autodeklarimit, kryen inspektim për verifikimin e kushteve të mjedisit dhe të autodeklarimeve të bëra nga subjekti. Nëse rezultati i inspektimit përputhet me autodeklarimin e subjektit, lëshohet një aktmiratim i përkohshëm, i cili është i vlefshëm për një periudhë 10-ditore, deri në përgatitjen e dokumenteve, që e licencon veprimtarinë.

8. Nëse brenda 20 ditëve, nga data e dorëzimit të formularit të autodeklarimit, institucioni shëndetësor i ngarkuar nuk shprehet, veprimtaria quhet e miratuar.

9. Vendimi nr.238, datë 10.4.2003 i Këshillit të Ministrave "Për licencimin e veprimtarisë private në fushën e shëndetësisë", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## VENDIM
## Nr.916, datë 2.7.2008

## PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË RROGOZHINË, TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Rrogozhinë, të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Rrogozhinë të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.16, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Rrogozhinës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Rrogozhinë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Bashkia Rrogozhinë

Lidhja 1

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës | Lloji i transferimit |
|---|---|---|
| 1,2 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës | Në pronësi |
| 4-9 | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore | Në pronësi |
| 11,12 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik | Në pronësi |
| 21-23 | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive | Në pronësi |
| 16-20 | Varrezat publike | Në pronësi |
| 32-57,59-280,282-285,288,291,292 | Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji | Në përdorim |
| 281,343-360,363 | Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike) | Në pronësi |
| 28 | Prona që përdoren në fushën e shërbimit social | Në pronësi |
| 13-15 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik | Në pronësi |
| 26,27 | Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile | Në pronësi |
| 364-370 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive) | Në përdorim |
| 371,374,377-379 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive) | Në pronësi |
| 380 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik | Në pronësi |
| 325 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e kanalizimeve | Në pronësi |

**VENDIM**
**Nr.917, datë 2.7.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS THUMANË TË QARKUT TË DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Thumanë të qarkut të Durrësit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Thumanë, të qarkut të Durrësit, miratuar me vendimin nr.650, datë 29.9.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Thumanë, të qarkut të Durrësit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Thumanë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Komuna Thumanë

Lidhja nr.1

| **Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit** | **Fusha e përdorimit të pronës** | **Lloji i transferimit** |
|---|---|---|
| 1-5 | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore | Në pronësi |
| 6-12 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik | Në pronësi |
| 13-20 | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive | Në pronësi |
| 21-40 | Varrezat publike | Në pronësi |
| 46,47,54,60,61,66,68,72-118,126,127,129,131,133,135,137,139,141-146,148,150-157,162-207,209,713-929 | Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji | Në përdorim |
| 41 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës | Në pronësi |
| 212,214,382-602,616-630 | Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike) | Në pronësi |
| 119-120,122,158-161 | Prona që përdoren në fushën e | Në pronësi |

| | | |
|---|---|---|
| | zhvillimit ekonomik | |
| 377-379 | Prona që përdoren në fushën e ujësjellës-kanalizimeve | Në pronësi |
| 43-45, 1289 | Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile | Në pronësi |
| 215-218 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive) | Në përdorim |
| 219-221,225,235,254,255, 264,329,340,348,356,361, 367,373,603,604 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive) | Në pronësi |

**VENDIM**
**Nr.918, datë 2.7.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË LAÇ TË QARKUT TË LEZHËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Laç të qarkut të Lezhës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Laç të qarkut të Lezhës, miratuar me vendimin nr.162, datë 25.3.2005 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Laç, të qarkut të Lezhës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Laç për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Bashkia Laç

Lidhja nr. 1

| **Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit** | **Fusha e përdorimit të pronës** | **Lloji i transferimit** |
|---|---|---|
| 118 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës | Në pronësi |
| 1-27 | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore | Në pronësi |
| 42,55,56 | Prona që përdoren për | Në pronësi |

| | | |
|---|---|---|
| | realizimin e funksioneve në shëndetin publik | |
| 28-35 | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive | Në pronësi |
| 533-535 | Varrezat publike | Në pronësi |
| 142-177,190,191,198,199, 203-330,375-532,564-575,577,578,586,588-591,599 | Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji | Në përdorim |
| 178-189,192-197,200-202,331-374,549,576,883-928,930-979,981-1043,1045-1108,1110-1167,1169-1222,1224-1238,1240-1246,1248-1278,1340-1430 | Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike) | Në pronësi |
| 536 | Prona që përdoren në fushën e shërbimit social | Në pronësi |
| 537,538,543,544,560-563,579-585,587,592-598,614-616,621,724-729,731-738,740-743,746-807 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik | Në pronësi |
| 65-98 | Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile | Në pronësi |
| 1436-1439 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive) | Në përdorim |
| 1440,1441,1523,1527 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive) | Në pronësi |
| 1501-1507 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e kanalizimeve | Në pronësi |

**VENDIM**
**Nr.919, datë 2.7.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS FIERZË TË QARKUT TË KUKËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Fierzë të qarkut të Kukësit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Fierzë të qarkut të Kukësit, miratuar me vendimin nr.165, datë 25.3.2005 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Fierzë, të qarkut të Kukësit".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Fierzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Komuna Fierzë — Lidhja nr.1

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës | Lloji i transferimit |
|---|---|---|
| 1-8 | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore | Në pronësi |
| 10-12 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik | Në pronësi |
| 9 | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive | Në pronësi |
| 16-40 | Varreza publike | Në pronësi |
| 83,83,86,88,89-90 (vetëm trojet e lira) | Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji | Në përdorim |
| 41-43,50-71 | Prona që përdoren në fushën e furnizimit me ujë | Në pronësi |
| 44-49,78-82,85,87 89-90 (Vetëm sheshet dhe sipërfaqet e gjelbëruara), 91-98 | Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike) | Në pronësi |
| 507,508,510-512,514,515 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive) | Në përdorim |
| 509,513 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive) | Në pronësi |
| 101-110 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e strehimit e të mbrojtjes civile | Në pronësi |
| 545-549 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik | Në pronësi |

**VENDIM**

**Nr.920, datë 2.7.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS SINJË TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Sinjë të qarkut të Beratit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Sinjë të qarkut të Beratit, miratuar me vendimin nr.638, datë 29.9.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Sinjë, të qarkut të Beratit".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Sinjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Komuna Sinjë Lidhja nr.1

| **Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit** | **Fusha e përdorimit të pronës** | **Lloji i transferimit** |
|---|---|---|
| 1-13 | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore | Në pronësi |
| 14-17 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik | Në pronësi |
| 19-21 | Prona që përdoren në fushën e kulturës dhe sportit | Në pronësi |
| 84-88 | Infrastrukturë (troje të lira) | Në përdorim |
| 18 | Administratë | Në pronësi |
| 22-71 | Shërbim funeral | Në pronësi |
| 82-83,89 | Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik | Në pronësi |
| 72-81,744-800 | Infrastrukturë (rrugë vendore) | Në pronësi |
| 821-828 | Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm (sisteme në administrim të komunës) | Në pronësi |
| 110,140 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive) | Në pronësi |
| 90-109,111-139,141-145 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka | Në përdorim |

| | | |
|---|---|---|
| | produktive) | |

**VENDIM**
**Nr.921, datë 2.7.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS TOPOJË TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Topojë të qarkut të Fierit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Topojë të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.735, datë 7.11.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Topojë, të qarkut të Fierit".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Topojë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Komuna Topojë Lidhja nr.1

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës | Lloji i transferimit |
|---|---|---|
| 1-12 | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore | Në pronësi |
| 13-19 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik | Në pronësi |
| 20-35 | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive | Në pronësi |
| 42,43 | Varreza publike | Në pronësi |
| 36-41,144-163 | Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike) | Në pronësi |
| 173-175 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve | Në pronësi |

| | | |
|---|---|---|
| 44-79 | Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile | Në pronësi |
| 137,138 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik | Në pronësi |
| 80,83,86,90 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive) | Në përdorim |
| 81,82,84,85,87,88,89,91,134-136 (vetëm kanalet e treta) | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive) | Në pronësi |

**VENDIM**
**Nr.922, datë 2.7.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË FIER TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Fier të qarkut të Fierit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Fier të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.831, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Fier, të qarkut të Fierit".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Bashkia Fier — Lidhja nr.1

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës | Lloji i transferimit |
|---|---|---|
| 1-5, 7-12 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative | Në pronësi |
| 13,15-43 | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore | Në pronësi |
| 14,89-92 | Prona që përdoren për ushtrimin | Në pronësi |

| | | |
|---|---|---|
| | e funksioneve në fushën e shërbimit social | |
| 52,53,54,55,56 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik | Në pronësi |
| 59-73 | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive | Në pronësi |
| 93 | Varreza publike | Në pronësi |
| 94,95,100-505,506-565,602 | Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike) | Në pronësi |
| 566-601 | Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji | Në përdorim |
| 617-776 | Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile | Në pronësi |
| 74-88,96-98,777-793,803-825 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik | Në pronësi |
| 794,798,800 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive) | Në përdorim |
| 795-797,799 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive) | Në pronësi |

**VENDIM**
**Nr.923, datë 2.7.2008**

## PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS ÇËRRAVË TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Çërravë të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Çërravë të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.424, datë 9.6.2005 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Çërravë, të qarkut të Korçës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Çërravë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Komuna Çërravë Lidhja nr.1

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës | Lloji i transferimit |
|---|---|---|
| 24-36 | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore | Në pronësi |
| 43-50 | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive | Në pronësi |
| 39-42 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë | Në pronësi |
| 15-23 | Varrezat publike | Në pronësi |
| 1-6 | Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji | Në përdorim |
| 7-14,65-81 | Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike) | Në pronësi |
| 82-90 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve | Në pronësi |
| 102-104 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive) | Në përdorim |
| 105-107,119,131,137,141, 144,160 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive) | Në pronësi |

**VENDIM**
**Nr.930, datë 2.7.2008**

## PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE TË QYTETIT, NË BASHKINË E SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga zgjerimi i varrezave të qytetit, në bashkinë e Shkodrës, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vlera e shpërblimit të pronarëve, për pasuritë, pronë private, me sipërfaqe 4 500 (katër mijë e pesëqind) $m^2$, tokë/arë, që shpronësohen, është 2 7000 000 (dy milionë e shtatëqind mijë) lekë dhe të përballohet nga granti konkurrues, dhënë bashkisë së Shkodrës, për vitin 2007.

3. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit është tre muaj pas miratimit të këtij projekti.

4. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë Shkodër dhe regjistrimi i ri i pasurisë prej 4 500 $m^2$ tokë/arë, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga bashkia e Shkodrës.

6. Afati i përfundimit të punimeve të objektit "Zgjerimi i varrezave publike të qytetit" të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia Shkodër.

7. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONIT DHE PRONËN QË DO TË SHPRONËSOHET PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE TË QYTETIT NË BASHKINË SHKODËR

| **Nr.** | **Emër, mbiemër** | **Zona kadastrale** | **Nr.pas.** | **Truall ($m^2$)** | **Çmimi (lekë)** | **Vlefta (lekë)** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Vat Nik Boshi | 1965 | 256/26 | 490 | 600 | 294 000 |
| 2. | Gjovalin Rrok Vukelaj | 1965 | 256/24 | 680 | 600 | 408 000 |
| 3. | Mark Mëhill Pjetri | 1965 | 256/22 | 760 | 600 | 456 000 |
| 4. | Mëhill Kol Pjetri | 1965 | 256/20 | 550 | 600 | 330 000 |
| 5. | Fran Kol Pjetri | 1965 | 256/18 | 995 | 600 | 597 000 |
| 6. | Nazie Mehmetaj<br>Kujtim Mehmetaj<br>Arben Mehmetaj<br>Shpëtim Mehmetaj | 1965 | 256/16 | 1025 | 600 | 615 000 |
| | | | **Shuma** | **4500** | **Shuma** | **2 700 000** |

## VENDIM
## Nr.931, datë 2.7.2008

### PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.335, DATË 2.9.1997 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8668, datë 23.11.2000 "Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 4 të vendimin nr.335, datë 2.9.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"-Titullari i institucioneve qendrore, në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## VENDIM
## Nr.932, datë 2.7.2008

### PËR PËRCAKTIMIN E PAGAVE DHE TË SHTESAVE MBI PAGË TË PUNONJËSVE SHQIPTARË, PËR KOHËN, QË SHËRBEJNË SI OFICERË KONTAKTI, PRANË MINISTRIVE TË BRENDSHME HOMOLOGE TË SHTETEVE TË NDRYSHME, TË ATASHUAR NË PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 e 47 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit shqiptarë të Ministrisë së Brendshme, të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, për kohën, që shërbejnë si oficerë kontakti, pranë ministrive të brendshme, homologe të shteteve të ndryshme, të trajtohen me pagë për gradë dhe shtesë për përfaqësim, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Për efekt të këtij trajtimi, paga e oficerëve të kontaktit të Ministrisë së Brendshme njësohet me pagën e gradës "Këshilltar", në shërbimin e jashtëm.

2. Oficerët e kontaktit, për kohën, që shërbejnë pranë ministrive të brendshme, homologe të shteteve të ndryshme, përfitojnë edhe kompensim për koston e jetesës, si më poshtë vijon:

- 300 euro/USD, për vendet e grupit të parë;
- 260 euro/USD, për vendet e grupit të dytë;
- 230 euro/USD, për vendet e grupit të tretë;
- 200 euro/USD, për vendet e grupit të katërt;
- 150 euro/USD, për vendet e grupit të pestë.

Kategorizimi i përfaqësive, për efekt të kostos së jetesës, është sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Trajtimi me pagë, sipas këtij vendimi, i oficerit të kontaktit fillon nga data e mbërritjes së tij në përfaqësi. Deri në këtë çast ai vazhdon të trajtohet me pagën e vendit të tij të mëparshëm.

4. Paga mujore i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat personale, sipas legjislacionit në fuqi.

Në bazë të pagës mujore do të paguhen edhe detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

5. Paga mujore i nënshtrohet rishikimit, në të njëjtën formë, si të gjitha kategoritë e tjera të pagave në Republikën e Shqipërisë.

6. Pagat për oficerët e kontaktit, që shërbejnë në vendet e Europës, bëhen në euro, ndërsa për vendet e tjera, në USD.

7. Pika 5 e vendimit nr.318, datë 4.7.2002 të Këshillit të Ministrave "Për vendosjen e oficerëve të kontaktit të Ministrisë së Rendit Publik pranë ministrive homologe të Greqisë, Italisë, Turqisë dhe UNMIK-ut, Kosovë, të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë", shfuqizohet.

8. Ministria e Brendshme, brenda fondeve buxhetore vjetore, të parashikuara në ligjin e buxhetit, të vitit përkatës kalendarik, të përballojë shpenzimet për pagat e oficerëve të kontaktit.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2008.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Lidhja nr.1

PAGA MUJORE E OFICERËVE TË KONTAKTIT TË MINISTRISË SË BRENDSHME, TË ATASHUAR NË PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

| **Pozicioni** | **Paga mujore** | |
|---|---|---|
| | Paga bazë mujore (në euro dhe në dollarë) | Shtesë për përfaqësimin në % |
| Oficer kontakti | 750 euro<br>950 dollarë (USD) | 40% |

Lidhja nr.2

KATEGORIZIMI NË BAZË TË KOSTOS SË JETESËS

| 300 euro/$ | 260 euro/$ | 230 euro/$ | 200 euro/$ | 150 euro/$ |
|---|---|---|---|---|
| Londër | Vjenë | Bruksel | Zagreb | Shkup |
| Gjenevë | Uashington | NATO | Kajro | Bukuresht |
| Moskë | Paris | Athinë | Janinë | Prishtinë |
| Kopenhagë | Romë | Ankara | Bari | Sofie |
| Bernë | Strasburg | Hagë | Kuala Lumpur | Podgoricë |
| Pekin | Berlin | Stokholm | Raid | Buenos Aires |
| Tokio | Madrid | Varshavë | | Bukuresht |
| Milano | Ottava | Budapest | | |
| Stamboll | | Pragë | | |
| | | Beograd | | |
| | | Selanik | | |
| | | Tel_Aviv | | |
| | | EUROPOL | | |

**VENDIM**
**Nr.933, datë 2.7.2008**

## PËR PËRFAQËSIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME ME OFICERË KONTAKTI NË BRITANINË E MADHE, BELGJIKË, ITALI, GREQI, TURQI, KOSOVË DHE EUROPOL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti, pranë ministrive homologe, në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Itali, Greqi, Turqi e në Republikën e Kosovës, të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, për të mbështetur luftën e përbashkët kundër trafikut ndërkombëtar të lëndëve narkotike, terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të armëve, emigracionit të paligjshëm dhe pastrimit të parave.

2. Përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti, pranë organizatës policore të EUROPOL-it.

3. Përfaqësimi në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Turqi e në Republikën e Kosovës të bëhet me nga 1 (një) oficer kontakti, ndërsa përfaqësimi në Greqi e Itali me nga 2 (dy) oficerë kontakti, përkatësisht, nga 1 (një) në Athinë e Selanik dhe nga 1(një) në Romë e Bari.

4. Oficerët e kontaktit emërohen nga Ministri i Brendshëm, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për një periudhë jo më pak se 2 (dy) vjet. Për emërimin e tyre njoftohen, zyrtarisht, ministritë homologe ose organet zyrtare përgjegjëse.

5. Ministri i Brendshëm mund t'i ngarkojë oficerët e kontaktit ta përfaqësojnë Ministrinë e Brendshme në më shumë se 1 (një) vend.

6. Oficerët e kontaktit, gjatë ushtrimit të detyrës, vazhdojnë të mbeten në organikën e institucionit, që i emëron, dhe, në përfundim të misionit, gëzojnë të drejtën e rikthimit në institucionin, ku kanë punuar përpara emërimit si oficerë kontakti.

7. Statusi, imuniteti dhe privilegjet, që gëzojnë oficerët e kontaktit, gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie, rregullohen sipas marrëveshjeve bazë (protokolleve), të nënshkruara ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe ministrive homologe, përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionet respektive.

8. Sistemimi me zyra i oficerëve të kontaktit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të bëhet në mjediset e përfaqësive tona diplomatike, ndërsa zyra e oficerit të kontakti në EUROPOL do

të jetë në zyrat qendrore të EUROPOL-it, në Hagë.

9. Vendimi nr.318, datë 4.7.2002 i Këshillit të Ministrave "Për vendosjen e oficerëve të kontaktit të Ministrisë së Rendit Publik, pranë ministrive homologe të Greqisë, Italisë, Turqisë dhe UNMIK-ut, Kosovë, të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikë së Shqipërisë", shfuqizohet.

10. Ngarkohet Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e aktit nënligjor, për detyrat dhe të drejtat e oficerëve të kontaktit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## VENDIM
## Nr.934, datë 2.7.2008

### PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME REPUBLIKËN E KIRIBATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Kiribatit.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## VENDIM
## Nr.935, datë 2.7.2008

### PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME REPUBLIKËN PALAU

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën Palau.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## VENDIM
## Nr.936, datë 2.7.2008

## PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME GRENADAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Grenadan.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## VENDIM
## Nr.937, datë 2.7.2008

## PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME REPUBLIKËN TRINIDAD DHE TOBAGO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën Trinidad dhe Tobago.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## VENDIM
## Nr.938, datë 2.7.2008

## PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME REPUBLIKËN E BELIZE-SË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Belize-së.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## VENDIM
## Nr.939, datë 2.7.2008

## PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME REPUBLIKËN E GAMBIAS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Vendosja e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Gambias.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.940, datë 2.7.2008**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME REPUBLIKËN E SWAZILENDIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Swazilendit.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.941, datë 2.7.2008**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME REPUBLIKËN E LIBERISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Liberisë.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.942, datë 2.7.2008**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME REPUBLIKËN DEMOKRATIKE TË TIMORIT LINDOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën Demokratike të Timorit Lindor.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.943, datë 2.7.2008**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME REPUBLIKËN E ÇADIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Çadit.
2.Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.944, datë 2.7.2008**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME REPUBLIKËN E UGANDËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 15 të ligjit nr.9095 datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Ugandës.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.945, datë 2.7.2008**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME REPUBLIKËN VANUATU**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën Vanuatu.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.946, datë 2.7.2008**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME REPUBLIKËN E BASHKIMIT TË KOMORROS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Bashkimit të Komorros.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.947, datë 2.7.2008**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME ISHUJT SOLOMON**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me ishujt Solomon.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.948, datë 2.7.2008**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME REPUBLIKËN E BAHAMAS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Bahamas.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.949, datë 2.7.2008**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME SAINT KITTS DHE NEVIS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Saint Kitts dhe Nevis.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.950, datë 2.7.2008**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME MBRETËRINË E TONGËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Mbretërinë e Tongës
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.951, datë 2.7.2008**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME SAINT VINCENT DHE GRENADINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Saint Vicent dhe Grenadinë.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.952, datë 2.7.2008**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME REPUBLIKËN E NAURUSË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Naurusë.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.953, datë 2.7.2008**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME ISHUJT TUVALU**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me ishujt Tuvalu.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.954, datë 2.7.2008**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME SHTETIN E PAVARUR TË SAMOAS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me shtetin e pavarur të Samoas.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.955, datë 2.7.2008**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME REPUBLIKËN E SURINAMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Surinamit.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.956, datë 2.7.2008**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME REPUBLIKËN E ISHUJVE MARSHALL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Ishujve Marshall.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.957, datë 2.7.2008**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME REPUBLIKËN E ISHUJVE TË FIXHIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Ishujve të Fixhit.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.958, datë 2.7.2008**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME SAINT LUCIA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Saint Lucia.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.959, datë 2.7.2008**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME ANTIGUA DHE BARBUDA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Antigua dhe Barbuda.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.960, datë 2.7.2008**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME REPUBLIKËN E KONGOS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Kongos.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.961, datë 2.7.2008**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME SHTETIN E PAVARUR**

**PAPUA GUINEA E RE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me shtetin e pavarur Papua Guinea e Re.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## VENDIM
## Nr.962, datë 2.7.2008

### PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME REPUBLIKËN E RUANDËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Ruandës.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## VENDIM
## Nr.963, datë 2.7.2008

### PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME SHTETET E FEDERUARA TË MIKRONEZISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shtetet e Federuara të Mikronezisë.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## VENDIM
## Nr.964, datë 2.7.2008

### PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 160, DATË 13.2.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE, PËR VITIN 2008, NË MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.160, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Ministrisë së Financave, në numrin total të punonjësve, të miratuar për vitin 2008, t'i shtohen 27 punonjës, për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

2. Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, në numrin total të punonjësve, të miratuar për vitin 2008, t'i shtohen 15 punonjës.

3. Numri total i punonjësve buxhetorë, për periudhën janar-dhjetor 2008, bëhet 104 167 veta, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Lidhja nr.1

| Gr. | Ministritë/institucionet | Janar-dhjetor 2008 |
|---|---|---|
| 3 | **Kryeministria** | **128** |
| | **Institucione të tjera qeveritare**, nga të cilat: | **106** |
| | -Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar | 33 |
| | -Agjencia e Prokurimit Publik | 36 |
| | -Grupi i Mbikëqyrjes | 8 |
| | -Komiteti Shtetëror i Minoriteteve | 9 |
| | -Agjencia Kombëtare Shoqërisë së Informacionit | 20 |
| 4 | **Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës**, nga e cila: | **508** |
| | -Drejtoria e Standardeve | 18 |
| 5 | **Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit,** nga e cila: | **2 109** |
| | -Bordet e kullimit | 650 |
| 6 | **Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit** | **1 362** |
| 10 | **Ministria e Financave**, nga e cila: | **3 135** |
| | -Drejtoria e Përgjithshme e Doganave | 1 027 |
| | -Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | 1 630 |
| | -Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave | 22 |
| 11 | **Ministria e Arsimit dhe Shkencës** | **43 220** |
| | -Universitetet | 3 833 |
| | - Parauniversitar | 38 496 |
| 12 | **Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve** | **1 105** |
| 13 | **Ministria e Shëndetësisë** | **15 408** |
| 14 | **Ministria e Drejtësisë**, nga e cila: | **4 594** |
| | - Avokati i Shtetit | 40 |
| | - Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme | 400 |
| | - Agjencia Kombëtare e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave | 150 |
| 15 | **Ministria e Punëve të Jashtme** | **188** |
| 16 | **Ministria e Brendshme,** nga e cila: | **13 065** |
| | - Drejtoria e Rezervave të Shtetit | 100 |
| 17 | **Ministria e Mbrojtjes** | **11 800** |
| 18 | **Shërbimi Informativ Shtetëror** | **950** |
| 20 | **Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave** | **155** |
| 22 | **Akademia e Shkencave** | **45** |
| 25 | **Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta** | **1 415** |
| 26 | **Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave** | **1 401** |
| 31 | **Agjencia Telegrafike Shqiptare** | **82** |
| 50 | **Instituti i Statistikës** | **169** |
| 57 | **Qendra Kombëtare e Kinematografisë** | **10** |
| 59 | **Instituti i Rehabilitimit të të Përndjekurve Politikë** | **25** |
| 78 | **Ministria e Integrimit** | **77** |
| 82 | **Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit** | **6** |
| | **Total** | **101 063** |

| | | |
|---|---|---|
| | **Totali për institucionet e pavarura** | **3 104** |
| | **Totali i punonjësve buxhetorë** | **104 167** |

**VENDIM**
**Nr.965, datë 2.7.2008**

## PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, (objekte, pjesa e dytë), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për objekte, me vlerë të përgjithshme 47 415 531 (dyzet e shtatë milionë e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e një) lekë.
4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 515 000 (pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 47 415 531 (dyzet e shtatë milionë e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e një) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë "Fondi i shpronësimeve" e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë.
6. Shpronësimi të fillojë më 30.6.2008 dhe të përfundojë më 30.9.2008.
7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Proces regjistrimi", të kompensohen, për efekt shpronësimi, me përfundimin e procesit të regjistrimit dhe pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, sipas dokumentacionit të pronësisë dhe hartave përkatëse, që do t'i vihen në dispozicion nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Mirditë.
9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Mirditë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

LISTA E PRONARËVE, PASURITË (OBJEKTE) NË PRONËSI TË TË CILËVE PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH

| Nr | Pronari | | | Nr. Pasurisë | Vlera lekë | Fshati | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri | Atësia | Mbiemri | | | | |
| 1. | Preng | Gjon | Marpepa | 173 | 1939220 | Mashterkor | Konfirmuar nga ZRPP |
| 2. | Ndue | Nikoll | Ndoj | 200 | 4172486 | Mashterkor | Konfirmuar nga ZRPP |
| 3. | Ardian | Fran | Prenga | 143 | 462661 | Mashterkor | Konfirmuar nga ZRPP |
| 4. | Ndue | Frrok | Marku | 170 | 2261755 | Mashterkor | Konfirmuar nga ZRPP |
| 5. | Agustin | Zef | Marku | 43/1 | 2054356 | Shtrungaj | Konfirmuar nga ZRPP |
| 6. | Pashk | Ded | Nikolli | 59/7 | 1783282 | Shtrungaj | Konfirmuar nga ZRPP |
| 7. | Gëzim | Mark | Gjoka | 81/11 | 1803086 | Shtrungaj | Konfirmuar nga ZRPP |
| 8. | Rrok | Gjet | Gjergji | | 1240632 | Zall-Xhuxh | Proces regjistrimi |
| 9. | Martin | Ndue | Gjeta | 30 | 2197050 | Zall-Xhuxh | Konfirmuar nga ZRPP |
| 10. | Zef | Llesh | Mena | 206 | 2929735 | Zall-Xhuxh | Konfirmuar nga ZRPP |
| 11. | Zef | Ndue | Karaci | 193 | 2588396 | Zall-Xhuxh | Konfirmuar nga ZRPP |
| 12. | Shkëlzen | Ded | Prendi | 88/2 | 418025 | Blinisht | Konfirmuar nga ZRPP |
| 13. | Mëhill | Kol | Gjoka | 112/4 | 1510837 | Blinisht | Konfirmuar nga ZRPP |
| 14. | Ndue | Mëhill | Gjoka | 112/5 | 2432437 | Blinisht | Konfirmuar nga ZRPP |
| 15 | Paulin | Ded | Prendi | 88/5 | 397917 | Blinisht | Konfirmuar nga ZRPP |
| 16. | Nikoll | Ndue | Gjergji | | 1880330 | Sang | Proces Regjistrimi |
| 17. | Ded | Ndue | Ndoj | 161 | 1837939 | Sang | Konfirmuar nga ZRPP |
| 18. | Ndue | Preng | Prenga | | 1216783 | Sang | Proces Regjistrimi |
| 19. | Gjok | Ndue | Ndoj | 162 | 2091319 | Sang | Konfirmuar nga ZRPP |
| 20. | Gjergj | Zef | Ndreca | 69/3 | 1546731 | Klos | Konfirmuar nga ZRPP |
| 21. | Cup | Nikoll | Boci | | 1426955 | Klos | Proces Regjistrimi |
| 22. | Kol | Ndue | Lleshi | 88/6 | 3493059 | Klos | Konfirmuar nga ZRPP |
| 23. | Dava | Nikoll | Tuci | 84/5 | 2021959 | Klos | Konfirmuar nga ZRPP |
| 24. | Pashk | Frrok | Nikolli | 144/1 | 1313121 | Geziq | Konfirmuar nga ZRPP |
| 25. | Gjet | Nikoll | Pershqefa | 60 | 2395460 | Bisak | Konfirmuar nga ZRPP |
| | | Totali | | | 47415531 | | |

**VENDIM**
**Nr.966, datë 2.7.2008**

**PËR KRITERET, QË DUHET TË PLOTËSOJNË PERSONAT, FIZIKË DHE JURIDIKË, PËR T'U PAJISUR ME LEJE PROFESIONALE, PËR PROJEKTIMIN, KONSULENCËN, VLERËSIMIN, MONITORIMIN DHE DREJTIMIN TEKNIK TË VEPRIMTARISË SË SHFRYTËZIMIT TË BURIMEVE MINERARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20 të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994 "Ligji minerar i Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personat, fizikë dhe juridikë, të cilët, për veprimtarinë e shfrytëzimit minerar, duan të pajisen, nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me leje profesionale, sipas kategorive:
- drejtues teknik,
- inxhinier projektues,

u nënshtrohen procedurave të testimit, para komisionit përkatës.

2. Për kërkim-zbulimin e burimeve minerare, përpunimin dhe pasurimin e mineraleve, të matjeve në veprimtari minerare dhe rehabilitimin e mjedisit, pas shfrytëzimit minerar, personat, fizikë dhe juridikë, me diplomën e arsimit të lartë, ushtrojnë lirisht veprimtarinë minerare, sipas profilit, në:
- drejtim teknik;
- projektim, konsulencë, vlerësim e monitorim.

3. Organizimi i procedurave, përbërja e komisionit të testimit dhe pagesa e anëtarëve të këtij komisioni përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

4. Personat, fizikë dhe juridikë, të cilët janë pajisur me leje profesionale projektimi dhe drejtimi teknik të veprimtarisë minerare, sipas kritereve të mëparshme, në përfundim të afatit të vlefshmërisë së lejes, u nënshtrohen procedurave të këtij vendimi.

5. Vendimi nr.54, datë 28.1.2005 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve për dhënien e lejeve profesionale specialistëve, që kryejnë projektimin, vlerësimin, konsulencën, monitorimin dhe drejtimin teknik të veprimtarisë minerare", të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.967, datë 2.7.2008**

**PËR MIRATIMIN E KUOTAVE KRYESORE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE NË UNIVERSITETIN USHTARAK "SKËNDERBEJ", PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 31 e 35 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat kryesore të pranimit, në universitetin ushtarak "Skënderbej", për vitin akademik 2008-2009, të jenë 140 (njëqind e dyzet) studentë, nga të cilët 15-20 për qind të jenë femra, të ndara si më poshtë vijon:

- Fakulteti i Menaxhimit, dega administrim-biznes, 90 (nëntëdhjetë) studentë.
- Fakulteti Teknik, dega elektronikë, 50 (pesëdhjetë) studentë.

2. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## VENDIM
## Nr.968, datë 2.7.2008

## PËR ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 36 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar" dhe të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 27.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

### KREU I
### AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

1. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, më poshtë Agjencia, është institucion buxhetor, në varësi të Ministrit të Financave.

2. Struktura dhe organika e Agjencisë përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Financave. Personeli i Agjencisë përbëhet nga profesionistë të fushave të ndryshme, në përputhje me natyrën e punës dhe objektin e veprimtarisë, si specialistë, dhe nga personeli ndihmës. Marrëdhëniet e punës rregullohen me ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3. Agjencia drejtohet nga kryeadministratori, i cili emërohet nga Ministri i Financave dhe ka këto detyra e përgjegjësi:

a) Drejton dhe organizon veprimtarinë dhe përgjigjet para Ministrit të Financave për veprimet e ndërmarra gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

b) Harton rregulloren e brendshme, të cilën ia paraqet për miratim Ministrit të Financave.

c) Përfaqëson Agjencinë në marrëdhënie me të tretët, në përputhje me rregulloren e brendshme.

4. Agjencia mund të kontraktojë edhe personel të jashtëm, si administratorë të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, a ekspertë të fushave të tjera, duke lidhur me ta kontratë pune, me kohë të pjesshme, apo kontratë shërbimi. Procedurat për lidhjen e këtyre kontratave caktohen nga Ministri i Financave, me propozimin e kryeadministratorit të Agjencisë.

5. Agjencia ka një buxhet të veçantë, si pjesë përbërëse e buxhetit të Ministrisë së Financave. Ky buxhet mbulon shpenzimet për mbajtjen dhe funksionimin e Agjencisë dhe shpenzimet për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Plani vjetor i punës dhe buxheti i Agjencisë miratohen nga Ministri i Financave.

### KREU II
### OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Agjencia ka për objekt të veprimtarisë:

a) administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara me vendim të gjykatës, në zbatim të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar";

b) administrimin e pasurive të sekuestruara, në zbatim të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit";

c) bashkëpunimin me institucionet pjesëmarrëse në procesin e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, si me gjykatat, prokurorinë, bankat, njësitë e qeverisjes vendore dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku ndodhen pasuritë e paluajtshme, të sekuestruara dhe të konfiskuara;

ç) përgatitjen e raportit të vlerësimit tekniko-financiar, të cilin ia paraqet për miratim Ministrit të Financave, në përputhje me pikat 2 e 3 të nenit 31 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar";

d) verifikimin dhe përgatitjen e dokumentacionit për kërkesat për financimin e projekteve nga fondi i posaçëm, për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimin ligjor, si dhe ndjek zbatimin e tyre;

dh) përgatitjen e raportit vjetor të administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, të cilin ia paraqet për miratim Ministrit të Financave, brenda datës 20 janar të vitit pasardhës.

## KREU III
## SHPENZIMET PËR ADMINISTRIMIN E PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

1. Shpenzimet e Agjencisë, për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, përfshijnë:

1.1 Shpenzimet e funksionimit të kësaj Agjencie.

1.2 Shpenzimet për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, të cilat përbëhen nga:

a) shpenzimet e marrjes në dorëzim;

b) shpenzimet e ruajtjes;

c) shpenzimet e sigurimit të domosdoshëm;

ç) shpenzimet e mirëmbajtjes;

d) shpenzimet për mundësimin e veprimtarisë në ato pasuri, të cilat mund të gjenerojnë të ardhura;

dh) shpenzimet për pagesën e administratorit të pasurisë dhe të personelit ndihmës, nëse ka të tillë;

e) shpenzimet për pagesën e shërbimeve të ekspertizës dhe të këshillimit teknik, për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara.

2. Shpenzimet për administrimin e secilës prej pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara kryhen nga Agjencia, me kërkesë të administratorit të pasurisë.

3. Shpenzimet për administrimin e secilës prej pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara përballohen nga të ardhurat e siguruara nga administrimi i tyre. Për ato pasuri, prej të cilave nuk mund të sigurohen të ardhura apo kur këto të ardhura nuk mjaftojnë, shpenzimet apo diferencat parapaguhen nga fondet e buxhetit të Agjencisë.

4. Në fund të periudhës së administrimit, shpenzimet e përballuara për administrimin e pasurisë përfshihen në llogaritë e administrimit të saj. Nëse fondet e siguruara në llogaritë e administrimit të pasurisë nuk mjaftojnë, ato paguhen, pjesërisht ose plotësisht, nga buxheti i Agjencisë, pa të drejtë kompensimi.

5. Procedurat dhe limitet e kryerjes së shpenzimeve për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

## KREU IV
## TË ARDHURAT NGA ADMINISTRIMI I PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

1. Administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara përfshin, por pa u kufizuar, ruajtjen dhe përdorimin e këtyre pasurive për nxjerrjen e të ardhurave.

2. Procedurat e mbledhjes dhe të administrimit të të ardhurave përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Ministri i Financave.

3. Sipas nenit 39 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004, krijohet fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimin ligjor, i cili administrohet nga Ministri i Financave, mbështetur në mendimin e komitetit këshillimor për masat kundër krimit të organizuar.

KREU V
ADMINISTRATORI I PASURISË

1. Pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara, të cilat janë objekt i veprimtarisë së Agjencisë, merren në administrim përmes një akti të marrjes në dorëzim, të mbajtur nga përfaqësues të autoritetit, që ka vendosur sekuestron, përfaqësues të Agjencisë dhe të administratorit të pasurisë.

2. Akti i marrjes në dorëzim të pasurisë shoqërohet me librat e llogarisë, nëse ka, të cilat Agjencia ia kërkon pronarit të pasurisë ose administratorëve. Në rast të mosparaqitjes së këtij dokumentacioni dhe nëse e gjykon të nevojshme, Agjencia mbledh të dhëna, në rrugë zyrtare, dhe ia vë në dispozicion ekspertit kontabël, të caktuar prej saj, i cili paraqet raportin përkatës.

3. Administratori përgatit një plan shpenzimesh dhe të ardhurash për pasurinë/të në administrim të tij, të cilin e dorëzon për miratim te kryeadministratori i Agjencisë.

4. Administratori kryen raportimet e parashikuara me ligj, si dhe përgatit raporte të tjera, me kërkesë të kryeadministratorit të Agjencisë.

5. Detyrat e administratorit të pasurisë përcaktohen në rregulloren e brendshme të Agjencisë.

KREU VI
MBAJTJA DHE EVIDENTIMI I TË DHËNAVE

1. Shpenzimet dhe të ardhurat nga administrimi i secilës prej pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara llogariten për kohën, gjatë së cilës janë marrë në administrim, dhe evidentohen në kartela të veçanta të pasurisë në administrim. Çdo veprim regjistrohet në bazë të dokumentacionit ligjor, përkatës.

2. Në fund të çdo viti financiar, Agjencia përgatit dhe paraqet te ministri i Financave raportin përmbledhës financiar të veprimtarisë.

3. Rregullat e hollësishme për mënyrën e mbajtjes dhe të evidentimit të shpenzimeve dhe të të ardhurave të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave.

KREU VII
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ministrisë së Financave, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, t'i shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, për përballimin e efekteve financiare, për ushtrimin e veprimtarisë së Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Vendimi nr.503, datë 30.6.2005, i Këshillit të Ministrave "Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara", i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.969, datë 2.7.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË ADMINISTRIM OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH), SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 ”Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi OSSH, sh.a.-së, sipas lidhjeve (gjithsej 1 416 fletë), që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Heqjen nga inventari i pronave të paluajtshme shtetërore, të sistemit të prodhimit, transmetimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, në përgjegjësi administrimi të KESH, sh.a.-së, miratuar me vendimin nr. 122, datë 4.3.2004, të Këshillit të Ministrave, të pronave të sistemit të shpërndarjes, sipas fletëve, të përcaktuara në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Ndryshimin e të dhënave, në inventarin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të prodhimit dhe të transmetimit të energjisë elektrike, në përgjegjësi administrimi të KESH, sh.a.-së, për pronat, sipas formularëve tip (tri fletë), që i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

3.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: METE KESH sh.a. — Identifikoi: Erion Bozgo, shef sektori
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Bashkia: Tiranë — Supervizoi: Çlirim Çomo Drejtor i DPP
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Fusha e përdorimit të pronës: KESH sh.a. — Aprovoi: Gjergj Bojaxhi, Drejtor i Përgjithshëm
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma,vula)

| | A | | B | | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. rendor | Zona kadastr.& indeksi i hartës | Nr. pasurisë | Emërtesa e pronës, vendndodhja/ shtrirja gjeografike | Kompetentët përbërës të pronës | Adresa/ vendndodhja e komponentëve përbërës | Përmasat e pronës në $m^2$ ose ml | Funksioni për të cilin përdoret prona | Institucioni/ enti me përgjegjësi administrative | Institucioni/ enti përdorues, statusi juridik i përdorimit | Të dhëna të tjera (shënime të veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| | | | | | | | | | | |
| 1 | | | | Godina e Institutit të Energjetikës | Blloku "Vasil Shanto" | 320 $m^2$ | Zyra të Administratës Qendrore të KESH | METE, KESH sh.a. | KESH sh.a. | Sip. ndërtimi 320$m^2$ një katëshe |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |

3.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: METE KESH sh.a. Identifikoi: Erion Bozgo, shef sektori
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Komuna: Qendër - Fier Supervizoi:Çlirim Çomo, Drejtor i DPP
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Fusha e përdorimit të pronës: KESH sh.a. Aprovoi: Gjergj Bojaxhi, Drejtor i Përgjithshëm
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma,vula)

| | A | | B | | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. rendor | Zona kadastr.& indeksi i hartës | Nr. pasurisë | Emërtesa e pronës, vendndodhja/ shtrirja gjeografike | Kompetentët përbërës të pronës | Adresa/ vendndodhja e komponentëve përbërës | Përmasat e pronës në $m^2$ ose ml | Funksioni për të cilin përdoret prona | Institucioni/ enti me përgjegjësi administrative | Institucioni/ enti përdorues, statusi juridik i përdorimit | Të dhëna të tjera (shënime të veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| | | | | | | | | METE KESH sh.a. | KESH sh.a. | |
| 1 | | | TEC FIER | TEC FIER | Komuna Qendër Fshati Drizë | 170.950$m^2$ | Prodhim energjie | ” | ” | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |

3.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: METE KESH sh.a. Identifikoi: Erion Bozgo, shef sektori
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Bashkia: Tiranë Supervizoi: Çlirim Çomo, Drejtor i DPP
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Fusha e përdorimit të pronës: KESH sh.a. Aprovoi: Gjergj Bojaxhi, Drejtor i Përgjithshëm
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma, vula)

| | A | | B | | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. rendor | Zona kadastr.& indeksi i hartës | Nr. pasurisë | Emërtesa e pronës, vendndodhja/ shtrirja gjeografike | Kompetentët përbërës të pronës | Adresa/ vendndodhja e komponentëve përbërës | Përmasat e pronës në $m^2$ ose ml | Funksioni për të cilin përdoret prona | Institucioni/ enti me përgjegjësi administrative | Institucioni/ enti përdorues, statusi juridik i përdorimit | Të dhëna të tjera (shënime të veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| | | | | | | | | METE KESH sh.a | KESH sh.a | |
| 1 | | | | Magazinat 6,7,8,9,10 | Bashkia Tiranë pranë Qytetit të Nxënësve Selitë | 9100 | Për magazina | ” | ” | Sip. ndërtimi 1600$m^2$ |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |

Shtojca nr.1

117-152;
155;
156 (pronat nr.5 e nr.6)
157;
158 (prona nr.2)
159-164;
166-177;
178 (pronat nr.2 e nr.3)
179-180;
181 (pronat nr.2, nr.3 e nr.4)
182 (pronat nr.2 e nr.3);
183-261;
263-284;
285;
286 (pronat nr.1/6, nr.1/7, nr.1/8, nr.1/9, nr.1/10, nr.1/11, nr.1/15 e nr.1/16)
287-650;
652-717;
724-782;
784-1 352.

**VENDIM**
**Nr.970, datë 2.7.2008**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I 6 PUSEVE TË SHPIMIT, NË KONJAT, LUSHNJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i 6 puseve të shpimit, në Konjat, Lushnjë.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve, sh.a., Lushnjë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës, e cila paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 900 (nëntëqind) $m^2$, tokë/arë, me vlerë shpronësimi 501 300 (pesëqind e një mijë e treqind) lekë.
4. Shpenzimet procedurale, në shumën 102 000 (njëqind e dy mijë) lekë, të përballohen nga Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve, sh.a., Lushnjë.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 501 300 (pesëqind e një mijë e treqind) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë "Fondi i shpronësimeve", e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë.
6. Shpronësimi të fillojë e të përfundojë brenda muajit korrik 2008.
7. Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve, sh.a., Lushnjë, të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
8. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Proces regjistrimi", a "Plotësim dokumentacioni", të kompensohen, për efekt shpronësimi,

pasi të ketë përfunduar procesi i regjistrimit dhe të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë subjektit kërkues, Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve, sh.a., Lushnjë.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve, sh.a., Lushnjë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

LISTA E PRONARËVE TË CILËT DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË 6 PUSEVE TË SHPIMIT NË STACIONIN E POMPAVE KONJAT, LUSHNJË

| Nr. | Emri | Sipërfaqja tokë/arë | Çmimi l/$m^2$ | Vlera në lekë | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Hamdi Isuf Nezha | 225 | 637 | 143 325 | Plotësim dokumentacioni |
| 2. | Ilir Adem Qose | 225 | 637 | 143 325 | Plotësim dokumentacioni |
| 3. | Bashkim Balil Duro | 225 | 477 | 107 325 | Plotësim dokumentacioni |
| 4. | Kadri Hazhi Misiri | 225 | 477 | 107 325 | Plotësim dokumentacioni |
| | Shuma | 900 $m^2$ | | 501 300 | |

Vlera totale e shpronësimit është 501 300 (pesëqind e një mijë e treqind) lekë.

**VENDIM**
**Nr.974, datë 2.7.2008**

**PËR DHËNIE FONDI KOMUNËS TËRTHORË, PËR REALIZIMIN E PROCEDURAVE PËR ZHVENDOSJEN E VARREZAVE TË FSHATIT MORINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komunës Tërthorë t'i jepet fondi 11 240 000 (njëmbëdhjetë milionë e dyqind e dyzet mijë) lekë, për realizimin e procedurave, për zhvendosjen e varrezave të fshatit Morinë, si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor Kalimash-Morinë, pjesë e autostradës Durrës-Kukës-Morinë.

2. Ky fond të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, "Fondi i shpronësimeve".

3. Procedurat për zhvendosjen e varrezave të fshatit Morinë të përfundojnë brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Përdorimi i fondit të bëhet në përputhje me udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave.

5. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Brendshme dhe komuna Tërthorë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi nr.808, datë 21.11.2007 i Këshillit të Ministrave "Për dhënie fondi komunës Tërthorë për realizimin e procedurave për zhvendosjen e varrezave të fshatit Morinë", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.976, datë 2.7.2008**

**PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË PALËS SHQIPTARE, PJESËMARRËSE NË OPERACIONIN USHTARAK "EUFOR TCHAD/RCA", TË BASHKIMIT EUROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të aktit normativ nr.3, datë 28.5.2008 të Këshillit të Ministrave "Për dërgimin në Republikën e Çadit dhe Republikën e Afrikës Qendrore, si kontribut i Republikës së Shqipërisë, të një kompanie të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për të marrë pjesë në operacionin "EUFOR TCHAD/RCA", të Bashkimit Europian", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes, brenda fondeve buxhetore, vjetore, të përballojë shpenzimet, në mbështetje të forcave shqiptare, pjesëmarrëse në operacionin ushtarak të Bashkimit Europian në Republikën e Çadit dhe Republikën e Afrikës Qendrore (operacioni "EUFOR TCHAD/RCA"), si shpenzime të drejtpërdrejta kombëtare, për:

a) evakuim mjekësor strategjik;

b) ndërlidhje strategjike;

c) shërbim postar dhe veprimtari të tjera zyrtare.

2. Efektet financiare, në vlerën 7 920 000 (shtatë milionë e nëntëqind e njëzet mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.977, datë 2.7.2008**

**PËR RISHPËRNDARJE FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË E MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 15 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

1. Në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, programi "Forcat e luftimit", të shtohet fondi 126 500 060 (njëqind e njëzet e gjashtë milionë e pesëqind mijë e gjashtëdhjetë) lekë, për përballimin e shpenzimeve të palës shqiptare, pjesëmarrëse në operacionin ushtarak të Bashkimit Europian, në Republikën e Çadit dhe Republikën e Afrikës Qendrore, (operacioni "EUROFOR

TCHAD/RCA”), fond, i cili t’i pakësohet programit “Mbështetje e përqendruar”.

2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.978, datë 2.7.2008**

**PËR KALIMIN NË PRONËSI NGA ARMO, SHA-JA, TIRANË, BASHKISË URA VAJGURORE TË NJË SIPËRFAQEJE, TRUALL, TË DEGËS SË SHPËRNDARJES SË KARBURANTEVE, URA VAJGURORE, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.208, DATË 16.4.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI ARMO, SHA-SË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 3 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi nga ARMO, sh.a.-ja, Tiranë, bashkisë Ura Vajgurore të një sipërfaqeje 3 234 (tre mijë e dyqind e tridhjetë e katër) $m^2$, truall, në zonën kadastrale 3682, me nr. pasurie 3/1, të degës së shpërndarjes së karburanteve, Ura Vajgurore, për ndërtimin e shkollës së mesme.

2. Në nr.36 të listës, që i bashkëlidhet vendimit nr.208, datë 16.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ARMO, sh.a.-së”, të bëhet ndryshimi përkatës.

3. Ky ndryshim të reflektohet edhe në vendimin nr.720, datë 30.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Ura Vajgurore, të qarkut të Beratit”.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ARMO, sh.a.-ja, bashkia Ura Vajgurore dhe zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**


PLANI I VENDOSJES SE SHKOLLES SE MESME 4 SHTATORI
URE VAJGURORE
SH: 1=500
SIPERFAQJA = 3234 M² TRUALL
TOPOGRAF
GURI NELAJ
BERAT
MIRATOHET:
KRYETAR BASHKIE
(AGIM BREGU)
URE VAJGURORE
RRUGA
G. BARDHE
GURI BARDHE
3/2
3/48
P/SEKT. URBANIST
ING. Thoma RUMNICI

**VENDIM**
**Nr.979, datë 2.7.2008**

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, TË NJË SIPËRFAQEJE, TRUALL, KOMUNITETIT TË SANT'EGIDIO-S (SHOQATË JOFITIMPRURËSE)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 901 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", të ndryshuar, dhe të nenit 7 të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit të Sant'Egidio-s, për selinë dhe veprimtarinë e këtij komuniteti në Shqipëri, të ratifikuar me ligjin nr.9628, datë 30.10.2006, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien, në përdorim, pa shpërblim, për një periudhë njëzetvjeçare, të sipërfaqes prej 1 008 (një mijë e tetë) $m^2$, në administrim të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Komunitetit të Sant'Egidio-s (shoqatë jofitimprurëse), për ndërtimin e një qendre të shëndetit mendor, për të pritur dhe rehabilituar persona me probleme të shëndetit mendor.
2. Autorizimin e Ministrisë së Shëndetësisë për të lidhur dhe zbatuar aktmarrëveshjen përkatëse me Komunitetin e Sant'Egidio-s (shoqatë jofitimprurëse), sipas legjislacionit në fuqi.
3. Autorizimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për të lidhur kontratën me këtë komunitet.
4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.980, datë 2.7.2008**

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, AKADEMISË SË EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTEVE "VOJO KUSHI", TË MJEDISEVE TË ISH-MENSËS SË STUDENTËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 901 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim, pa shpërblim, Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve "Vojo Kushi", të mjediseve të ish-mensës së studentëve (kati përdhes i ndërtesës së konviktit, që ndodhet brenda territorit të kësaj akademie), pronë publike, në administrim të Ndërmarrjes nr.2 të Trajtimit të Studentëve, sh.a., për ngritjen e Bibliotekës Kombëtare të Sportit.
2. Autorizimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për të lidhur aktmarrëveshjen (kontratën) përkatëse me Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve "Vojo Kushi", në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
3. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**URDHËR**
**Nr.82, datë 19.6.2008**

## PËR MIRATIMIN E PRIMIT TË PASTËR TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË MBAJTËSVE TË MJETEVE MOTORIKE PËR PËRGJEGJËSINË NDAJ PALËVE TË TRETA

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 16 të ligjit nr.7641, datë 1.12.1992 "Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.295, datë 15.9.1992 "Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta", i ndryshuar", të rregullores së datës 7.5.2002 "Për disa shtesa në rregulloren nr.622/1, datë 15.12.1992 "Për zbatimin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta"", të nenit 100 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", me propozim të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

URDHËROJ:

1. Primi i pastër për sigurimin e detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për kontratat TPL e brendshme, me afat njëvjeçar, të jetë si më poshtë:

| **Kat** | **Klasa** | **Tipi** | **Kapaciteti motorik ($cm^3$) ose pesha bartëse (ton) ose numri i vendeve** | **Primi i pastër (në lekë)** |
|---|---|---|---|---|
| A 1 | | Motoçikleta | Kapaciteti motorik | |
| | A 1/1 | | Deri në 150 $cm^3$ | 2.600 |
| | A 1/2 | | Mbi 150 $cm^3$ | 4.400 |
| | | | | |
| B 1 | | Autovetura | Kapaciteti motorik | |
| | B 1/1 | | Deri në 1600 $cm^3$ | 6.300 |
| | B 1/2 | | Mbi 1600 $cm^3$ | 9.200 |
| B 2 | | Furgona, mikrobuzë | Nr. i vendeve | |
| | B 2/1 | | Nga 5 deri në 8 vende | 12.700 |
| | B 2/2 | | Mbi 8 deri në 15 vende | 17.500 |
| | | | | |
| C 1 | | Autobusë | Mbi 15 vende | 28.000 |
| | | | | |
| D 1 | | Kamionçina | Pesha mbajtëse deri në 3.5 ton | 12.300 |
| D 2 | | Kamionë | Pesha mbajtëse mbi 3.5 ton | 20.400 |
| | | | | |
| E | | Rimorkio | Të të gjitha llojeve | 5.900 |
| | | | | |
| F | | Mjete bujqësore | | 4.600 |
| | | | | |
| G | | Zjarrfikëse | | 10.500 |

2. Primi i pastër i sigurimit të detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, për kontratat kufitare të sigurimit, të jetë si më poshtë:

| **Kat** | **Tipi i mjetit** | **Primi në euro** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 15 | 20 | 25 | 30 | 45 | Njëvjeçare |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ditore | ditore | ditore | ditore | ditore | |
| A | Autovetura | 17 | 21 | 24 | 28 | 31 | 150 |
| B.1 | Motoçikleta | 8 | 10 | 12 | 14 | 17 | 60 |
| B.2 | Motokarro | 10 | 14 | 17 | 21 | 24 | 75 |
| C.1 | Kamion për mallra nga 15 deri 34.99 Kv | 56 | 70 | 84 | 91 | 105 | 240 |
| C.2 | Kamion për mallra nga 35 Kv e lartë | 70 | 84 | 91 | 105 | 126 | 400 |
| D | Ciklomotor | 8 | 10 | 12 | 14 | 17 | 60 |
| E | Autobusë | 98 | 112 | 133 | 147 | 174 | 400 |
| F.1 | Rimorkio kamioni | 42 | 49 | 56 | 63 | 77 | 100 |
| F.2 | Rimorkio autobusi | 56 | 63 | 70 | 77 | 98 | 150 |
| F.3 | Rimorkio të tjera | 21 | 28 | 35 | 42 | 49 | 100 |

3. Provigjoni i primit të pafituar të llogaritet për çdo policë sigurimi, si pjesë proporcionale e primit të pastër, të përcaktuar në këtë urdhër, për periudhën e paskaduar të policës së sigurimit.

4. Moszbatimi i primit të pastër, të përcaktuara në këtë urdhër, i bën shoqëritë e sigurimit subjekt të sanksioneve të përcaktuara në nenin 165 e vijues të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", i ndryshuar.

5. Ngarkohen shoqëritë e sigurimit dhe Byroja Shqiptare e Sigurimit për zbatimin e këtij urdhri, i cili është subjekt mbikëqyrjeje nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

6. Me fillimin e efekteve të këtij urdhri, shfuqizohet urdhri i Ministrit të Financave nr.70, datë 20.7.2007 "Për miratimin e primit të pastër të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta".

7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i fillon efektet nga data 15.8.2008.

MINISTRI I FINANCAVE
**Ridvan Bode**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,** në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 22.7.2008
Doli nga shtypi më 23.7.2008

| | |
|---|---|
| Tirazhi: 3300 copë | Formati: 61x86/8 |

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 52 lekë